



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

NJOFTIM

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Ligjit Nr. 10 107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar dhe të pikës 3, të Vendimit Nr. 861, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e njohjes së audituesve klinikë, kryerjen e procesit të auditimit dhe përcaktimin e tarifave të pagesës së audituesve”, njoftohet fillimi i procesit të përzgjedhjes së audituesve klinikë.

Kriteret e nevojshme për njohjen si auditues klinik:

- a) Të ketë profesionin mjek/farmacist/stomatolog;
- b) Të ketë minimumi 15 vjet eksperiencë profesionale në sistemin shëndetësor, të vërtetuar nga institucionet publike dhe jopublike të certifikuara dhe të akredituara sipas legjislacionit në fuqi;
- c) Të ketë titullin profesor, profesor i asociuar;
- ç) Të ketë njohuri për përdorimin e kodifikimit mjekësor (ICD);
- d) Të ketë njohuri për auditin klinik dhe manualin e procedurave të auditit klinik;
- dh) Të ketë njohuri mbi protokollet dhe udhërrëfyesit e praktikës mjekësore dhe standardet e akreditimit për fushën përkatëse.

Dokumentacioni i nevojshëm për t’u dorëzuar:

1. Kërkesën për shprehjen e interesit
2. Licenca e ushtrimit të profesionit (mjek/farmacist/stomatolog);
3. Jetëshkrim lidhur me përvojë profesionale;
4. Vërtetime lidhur me eksperiencën profesionale;
5. Aktin e fitimit të titullit akademik;
6. Vetëdeklarimin se ka njohuri për përdorimin e kodifikimit mjekësor (ICD);
7. Vetëdeklarimin se ka njohuri për auditin klinik dhe manualin e procedurave të auditit klinik;
8. Vetëdeklarimin se ka njohuri mbi protokollet dhe udhërrëfyesit e praktikës mjekësore dhe standardet e akreditimit për fushën përkatëse;
9. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore.

Dokumentacioni duhet të jetë i noterizuar dhe të dorëzohet në një zarf tek Zyra e Protokollit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

**Shënim:*

Përjashtim nga detyrimi për dorëzimin e dokumenteve të mësipërme bëhet për audituesit e huaj klinikë, të cilët doëzojnë dokumentin zyrtar që vërteton njohjen si të tillë në vendin e tyre.

Procesi i zgjedhjes

Procesi i vlerësimit të personave të cilët shprehin interesin për t'u njohur si auditues klinikë do të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi, veçanërisht në mbështetje të Ligjit Nr. 10 107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar dhe të pikës 3, të Vendimit Nr. 861, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e njohjes së audituesve klinikë, kryerjen e procesit të auditimit dhe përcaktimin e tarifave të pagesës së audituesve” dhe Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. “Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Audituesve Klinikë”.